



MALI I ZI  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
ENTI PËR KRYERJEN E SANKSIONEVE PENALE

MANUAL I SHKURTËR PËR TË DREJTAT DHE  
DETYRIMET E TË BURGOSURVE/BURGOSURAVE



Projektin e financon Bashkimi Evropian  
me ndërmjetësimin e Delegacionit të  
Bashkimit Evropian në Mal të Zi



Ambasada e Republikës  
Federale të Gjermanisë  
në Podgoricë

Ky publikim është realizuar në Bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë-Entin për Kryerjen e Sanksioneve Penale, në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të drejtave të njeriut në institucionet e tipit të mbyllur në Mal të Zi”, të cilin Aksioni për të Drejtat e Njeriut, si bartës i projektit, e ka realizuar së bashku me Qendrën për Arsim Qytetar, Qendrën për Antidiskriminim “Ekvista” dhe Shtëpinë e Sigurtë të Gruasë. Publikimi është realizuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian, me ndërmjetësimin të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Mal të Zi dhe Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Podgoricë. Përmbajtja e këtij publikimi është në përgjegjësinë ekskluzive të Aksionit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk shprehë qendrimet e donatorit.

MANUAL I SHKURTËR  
PËR TË DREJTAT  
DHE DETYRIMET E  
TË BURGOSURVE/  
BURGOSURAVE



# Manual i shkurtër për të drejtat dhe detyrimet e të burgosurve/ burgosurave

Qëllimi i këtij manuali është që të Ju njoftoj me të drejtat themelore dhe detyrimet Tuaja. Me termin i/e burgosur/ë nënkuptohen personat të cilët janë dënuar, për kundërvajtje ose janë paraburgosur, pra të gjithë personat të cilëve në bazë të vendimit të një organi shtetëror u është privuar liria dhe ndodhen në burg.

Të drejtat themelore dhe detyrimet e të burgosurve dhe të burgosurave janë të përcaktuara në bazë të rregullave të mëposhtme:

- Ligjit mbi Kryerjen e Sanksioneve Penale dhe Rregullores së Rendit Shtëpiak për kryerjen e dënimeve me burgim në Entin për Kryerjen e Sanksioneve Penale – për personat e dënuar;
- Ligjit mbi Procedurën Penale dhe Rregulloren mbi mënyrën më të afërt për kryerjen e paraburgimit – për personat e paraburgosur;

- Ligjin për Trajtimin e të Miturve në Procedurat Penale;

Këto rregulla, si dhe Kodi Penal, Ligji mbi Mbrojtësin/en e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi dhe Rregullat e Punës së Mbrojtësit/es së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi, duhet të jenë në dispozicion për të gjithë personat në burg.

**ME RËNDËSI:** Të burgosurit dhe të burgosurat kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë juridike(ligjore) në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre në burg.

Burgu është i detyruar t'u sigurojë ndihmë ligjore në lidhje me marrjen e veprimeve të nevojshme për të mbrojtur të drejtat e tyre, posaçërisht nëse kjo ka të bëjë me trajtimin e tyre dhe kushtet e qëndrimit në burg. Pra, secili person në burg mund t'i drejtohet shërbimit juridik të burgut për të fituar ndihmë juridike.

## PËRMBAJTJA

<b>Të drejtat e të burgosurve/burgosurave</b> ....	<b>11</b>
Ndalimi i abuzimit .....	11
Përdorimi i mjeteve të forcës .....	12
Pranimi në Ent .....	13
Kushtet e qëndrimit në Ent .....	15
Gjërat të cilat mund të posedoni .....	16
Mirëmbajtja e higjienës .....	17
Mbrojtja shëndetësore .....	18
Qendrimi në ajër të pastër .....	20
Orari ditor .....	20
Vizitat .....	20

Letërkëmbimi .....	22
Pranimi i dërgesave .....	22
Bisedat telefonike .....	23
Jeta martesore .....	23
Puna dhe paga për punë .....	24
Arsimimi .....	24
Biblioteka .....	25
<b>Akomodimi i grupeve të veçanta të burgosurve/ burgosurave dhe trajtimi i tyre .....</b>	<b>26</b>
Personat me invaliditet .....	26
Personat e mitur .....	27
Gratë ( <i>Femrat</i> ) .....	27
<b>Masat e veçanta .....</b>	<b>28</b>
Izolimi .....	28
Transferimi .....	29



<b>Procedura disiplinore</b> .....	<b>30</b>
Procedura disiplinore .....	30
Procedura disiplinore në paraburgim .....	32
Dërgimi në birucë .....	33
<b>Mbrojtja e të drejtave</b> .....	<b>34</b>
Ankesa brenda Entit .....	34
Ankesa Ministrisë së Drejtësisë .....	35
Ankesa kryetarit të gjykatës ose gjyqtarit i cili mbikëqyrë kryerjen e paraburgimit ...	34
Mbrojtja në procesin para Gjykatës Administrative .....	34
Mbrojtja në procedurën të cilën e udhëheq Mbrojtësi/ja e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut i/e Malit të Zi .....	36
Mbrojtja gjyqësore .....	37



## Të drejta e të burgosurve / burgosurave

Secili person në burg ka të drejtë të trajtohet njerëzisht dhe me respekt për dinjitetin njerëzor.

### ✓ **Ndalimi i abuzimit**

Ndalohet çdo abuzim fizik ose psikik i personave në burg. Pra, të punësuarit në burg nuk guxojnë në çfarëdo mënyre të keqtrajtojnë të burgosurin/burgosuren, e as të lejojnë që ata të jenë të keqtrajtuar nga ana e të burgosurve/burgosurave të tjerë/a. Zyrtarët/et e sigurimit janë të obliguar që secilit person t'i ofrojnë mbrojtjen e nevojshme. Në rast të keqtrajtimit, mund t'i drejtoheni shefit të turnit në mënyrë anonime, të kërkonin një audiencë te drejtori i burgut, t'i drejtoheni Drejtorisë së EESP-së përmes kutisë së shkresave ose me ndërmjetësimin e zbatuesit të trajtimit, mund t'i shkruani edhe drejtëpërdrejtë Mbrojtësit/es së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut përmes kutisë së shkresave të

cilat zyrtari/ja i/e institucionit drejtëpërdrejtë i hap çdo javë.

### ✓ ***Përdorimi i mjeteve të forcës***

Personat e punësuar në shërbimin e sigurimit mund të përdorin forcën vetëm atëherë kur janë plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj. Me fjalë të tjera, mjetet e forcës mund të përdoren vetëm kur janë të domosdoshme për parandalimin e:

- ikjes;
- sulmeve fizike ndaj personit zyrtar ose të burgosurit;
- lëndimit të një personi tjetër;
- vetëlëndimit;
- shkaktimit të dëmit material;
- kur është e nevojshme për të parandaluar rezistencën ndaj urdhrave të ligjshëm të oficerëve.

Me ligj lejohet përdorimi i mjeteve të forcës: forcës fizike, lidhjes, shkopit prej gome, tubave me ujë, qenve të trajnuar posaçërisht, mjeteve kimike dhe armëve të zjarrit.

Nëse merrni lëndime për shkak të përdorimit të mjeteve të forcës nga ana e zyrtarëve/eve të burgut, keni të drejtë në vizitë dhe ndihmë mjeksore. Mjeku është i obliguar të bëjë evidencimin e deklaratës Suaj mbi prejardhjen e këtyre lëndimeve dhe të japë përshkrimin e lëndimit deri në detaje në kartonin Tuaj shëndetësor. Në rast të dyshimit për abuzim, drejtoria e burgut është e obliguar të njoftojë policinë dhe prokurorin shtetëror.

### ✓ **Pranimi në Ent**

Secili person menjëherë, me pranimin në burg, duhet të kontrollohet nga ana e mjekut.

Personi i pranuar për kryerjen e ndëshkimit është i obliguar të kumtojë të dhënat e sakta për veten dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë me adresat dhe numrat e telefonit të plotë dhe të saktë, nëse i posedon, me qëllim të regjistrimit në listën personale dhe kartonin e vizitave, si dhe të parashtrojë emrin e avokatit të vet.

Personat e dënuar me pranim në burg akomodohen në Departamentin për Eksplorimin e Personalitetit (të ashtuquajturin „karantin“), të ndarë nga të burgosurit/at e tjerë/a. Këtu mund të qëndrojnë më së shumti 30 ditë.

Në Departamentin për Eksplorimin e Personalitetit kryhen testimet e personit të dënuar nga aspektet sociale, mjekësore, kriminologjike, psikologjike, pedagogjike dhe të sigurisë.

Në bazë të rezultateve të eksplorimit të personalitetit, në varësi nga kohëzgjatja e dënimit, lloji i veprës penale, dënimi i mëparshëm, karakteristikat individuale, mënyra e ardhjes në kryerjen e dënimit, si dhe rrethanat e tjera, përcaktohet programi i trajtimit të personit të dënuar, i cili përmban:

- grupin për klasifikim në të cilën personi i dënuar klasifikohet;
- akomodimin (reparti i mbyllur dhe gjysmë i hapur) dhe emërtimin e pavionit për banim;
- grupin e trajtimit;
- vendin e punës;

- mënyrën e aftësimit për arsim fillor të detyrueshëm dhe mundësinë për aftësim profesional;
- aktivitetet sportive, kulturo-artistike dhe të lira;
- intenzitetin e punës individuale dhe të punës në grup dhe masave të tjera të trajtimit të personit të dënuar.

Në fund të qëndrimit në Departamentin për Eksplorimin e Personalitetit ( „karantin“), bëhet klasifikimi i personave të dënuar në njërën nga katër grupet e klasifikimit

Çdo katër muaj kryhet riklasifikimi, gjegjësisht bëhen ritestimet se a duhet mbajtur personin e dënuar në grupin e klasifikuar apo duhet ndryshuar grupin.

Procedura e klasifikimit dhe riklasifikimit është përcaktuar me Rregulloren mbi rendin shtëpiak.

### ✓ ***Kushtet e qëndrimit në Ent***

Secili person në burg ka të drejtë të qëndroj në kushte dinjitoze për qeniet njerëzore.

Secilit/ës të burgosur duhet t'i sigurohet

krevati me çarçafët e pastër. Do të Ju mundësohet që të përdorni edhe çarçafët tuaj personal.

Në ambientet në të cilat qendrojnë të burgosuri/at duhet të ekzistojë edhe dritë e natyrs-hme dhe ndriçim artificial, të mjafteshme sa të mund të lexohet pa pëngesa për të parë. Ambientet duhet të jenë të ajrosura dhe të ngrohta.

Të bugosurve/bugosurave duhet tu mundësohet të mbajnë higjiienën personale.

### ✓ ***Gjëra të cilat mund të posedoni***

Me pranim në burg, te vetja mund të mbani gjërat e përcaktuara me Rregulloren mbi rendin shtëpiak, më saktësisht:

- Paisjet për mirëmbajtjen e higjiienës personale (sapun, furçë dhe pastë dhëmbësh, shampo për flokë, gotë plastike, krehër dhe prerëse thonjësh), prej preparateve kozmetike kremë për duarë, ndërsa femrat mund të mbajnë edhe mjete të tjera higjiienik – peceta gigjiienike;
- Paisjet për rroje, përveç briskut dhe zhiletave, kurse femrat skedar-grihë për thon-



jët me gjatësi deri 3 cm, pincetë, furçë dhe tharëse për flokë;

- Aksesorë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrobave (brushë, pe dhe gjilpërën);
- Cigare duhani dhe paisjet për pirjen e duhanit;
- Paisjet për shkrim;
- Mjete ortopedike, syze;
- Paisje sportive (bluzë, pantallona të shkurtra, kostume-komplete sportive dhe atlete);
- Fotografitë familjare, shkresat dhe dokumentacionin lidhur me aktgjykimin;
- Artikuj ushqimorë, sipas kushteve të përcaktuara me Rregulloren mbi rendin shtëpiak.

### ✓ ***Mirëmbajtja e higjienës***

Në burg jeni të obliguar që çdo ditë të mbani higjienën e përgjithshme dhe personale. Në burg ekziston edhe dhoma për larjen e rrobave. Mënyra e mirëmbajtjes së higjienës është përcaktuar me Rregulloren mbi rendin shtëpiak, gjegjësisht Rregulloren për mënyrën më të detajuar për kryerjen e burgut.

Nëse nuk punoni dhe nuk keni mjete financiare, do të Ju sigurohen paisje për higjienën personale (sapuni, furça, pastë dhëmbësh dhe paisjet për rroje).

### ✓ **Mbrojtja shëndetësore**

Çdo të burgosur me pranim në burg, në afatin kohor prej 24 orësh e kontrollon mjeku, i cili hap një karton dhe në të vendos të gjitha të dhënat e rëndësishme. Në interesin Tuaj më të mirë është që të kumtoni informata të sakta për shëndetin Tuaj.

Të gjithë personat në burg gëzojnë të drejtën për mbrojtje shëndetësore. Në parim, ai duhet të jetë i barabartë me mbrojtjen që e gëzojnë edhe personat të cilët ndodhën në liri.

Keni të drejtë të kërkonti që të Ju kontrollojë mjeku. Për kontrollim i paraqiteni zyrtarit/es të sigurisë në pavionin ku jeni të vendosur, me rastin e numërimit në darkë. Për shikim mund t'i paraqiteni edhe teknikut mjekësor me rastin e ndarjes së terapisë së mbrëmjes. Shikimi kryhet

ditën e parë të ardhshme të punës, kurse në rastet urgjente menjëherë.

Shikimet mjekësore i kryen mjeku në prani të teknikut mjekësor. Zyrtarët/et e Sektorit të Sigurisë janë të pranishëm në kontrollim vetëm nëse mjeku vlerëson se prania e tyre është e domosdoshme.

Shpenzimet e mbrojtjes shëndetësore i mbulon Mali i Zi. Mirëpo, nëse Ju mundësohet që të shfrytëzoni shërbimet e mjekut të cilin e zgjedhni, atëherë këtë shërbim do ta paguani vetë.

Me propozimin ose me lejen e mjekut të burgut, mund të furnizoheni me ilaçe edhe me shpenzimin tuaj. Medikamentet ruhen në ambulancën e njësisë organizative dhe i jepen të burgosurit nën mbikqyrje dhe sipas udhëzimeve të mjekut të burgut.

Informatat më të afërta lidhur me ofrimin e mbrojtjes shëndetësore të përcaktuara me Ligj mbi kryerjen e Sanksioneve Penale dhe Rregulloren mbi rendin shtëpiak.

### ✓ **Qendrimi në ajër të pastër**

Të gjithë personat e burgosur, pa përjashtim, kanë të drejtë që çdo ditë të shëtisin në ajër të pastër.

Të dënuarit dhe personat e dënuar për kundërvajtje kanë të drejtë që të qëndrojnë në ambiente të hapura më së paku një orë në ditë.

Personat e paraburgosura kanë të drejtë që të qëndrojnë dy orë në ditë në ambientet e hapura, të dedikuara për shëtitje.

### ✓ **Orari ditor**

Orari ditor për personat e dënuar dhe personat e ndëshkuar për kundërvajtje është përcaktuar me Rregulloren mbi rendin shtëpiak, ndërsa për personat në paraburgim me Rregulloren për mënyrën më të detajuar për kryerjen e paraburgimit.

### ✓ **Vizitat**

Të dënuarit dhe personat e dënuar për kundërvajtje mund të pranojnë vizitat e më të afërmeve, ndërsa me lejen e shefit të organiza-

tës mund t'i vizitojnë edhe persona të tjerë. Vizitat mund t'i pranojnë dy herë në muaj, me kohëzgjatje prej një orë.

Personi i paraburgosur, me lejen e gjykatësit gjegjës dhe sipas nevojës me mbikqyrje të tij ose të personit që ai do të caktojë, mund ta vizitojnë bashkëshorti/ja ose personi me të cilin është në bashkësi jashtëmartesore dhe më të afërmit, kurse me kërkesën e tij mund ta vizitojë mjeku dhe personat e tjerë. Vizitat e personave të paraburgosur organizohen një herë në javë, në kohëzgjatje prej tridhjetë minutave. Gjykatësi për investigim ose personi të cilin do të caktojë ai mund të përcaktojë edhe afat kohor më të gjatë për vizita.

Mënyra në të cilën kryhen vizitat është rregulluar me Ligjin për kryerjen e Sanksioneve Penale dhe Rregulloren mbi Rendin Shtëpiak për të burgosurit dhe personat e dënuar për kundërvajtje, gjegjësisht me Kodin mbi Procedurën Penale dhe me Rregulloren për mënyrën më të detajuar për kryerjen e burgut për personat në paraburgim.

### ✓ **Letërkëmbimi**

Të gjithë personat në burg kanë të drejtë në letërkëmbim. Shkëmbeni letrat, sipas rregullave, dhe me shpenzimin tuaj.

Personave të dënuar të cilët nuk punojnë pa fajin e tyre, dhe të cilët nuk kanë mjete financiare, u mundësohet që të dërgojnë dy letra në muaj me shpenzimet e burgut.

Mënyra në të cilën kryhet letërkëmbimi është rregulluar me Ligjin për kryerjen e Sanksioneve Penale dhe Rregulloren mbi rendin shtëpiak për të burgosurit dhe personat e dënuar për kundërvajtje, gjegjësisht me Kodin për Procedurën Penale dhe me Rregulloren për mënyrën më të detajuar për kryerjen e burgut për personat në paraburgim.

### ✓ **Pranimi i dërgesave**

Personat në burg kanë të drejtë të pranojnë dërgesat.

Çfarë dërgesash të jenë, çka mund të përbajnë, në cilën mënyrë dhe sa shpeshë mund të pranohen është përcaktuar me Ligjin për kryerjen e Sanksioneve Penale dhe Rregulloren mbi ren-

din shtëpiak për të dënuarit dhe personat e ndëshkuar për kundërvajtje, gjegjësisht me me Rregulloren për mënyrën më të detajuar për kryerjen e burgut për personat në paraburgim.

### ✓ **Biseda telefonike**

Personat në burg mund të telefonojnë me shpenzimin e vet.

Kushtet në bazë të të cilave mund të kryejnë bisedën telefonike janë të përcaktuara me Rregulloren e rendit shtëpiak për të dënuarit dhe personat e ndëshkuar për kundërvajtje, gjegjësisht me Rregulloren për mënyrën më të detajuar për kryerjen e burgut për personat në paraburgim.

### ✓ **Jeta martesore**

Personi i dënuar ka të drejtë që ta vizitojë bashkëshorti/ja një herë në muaj në kohëzgjatje prej katër orëve.

Vizitat bashkëshortore kryhen në një hapësirë të posaçme, në të cilën është siguruar privatesia, ditëve të punës, në intervalin kohor prej orës 8 deri në orën 16.

### ✓ ***Puna dhe paga për punë***

Me kushtet e përcaktuar me Rregulloren mbi rendin shtëpiak, personat e dënuar mund të angazhohen për punë, nëse e dëshirojnë këtë.

Personat e dënuar të angazhuar me punë kanë të drejtë për pagë adekuate në përputhje me ligjin.

Mënyra e punës, detyrimet dhe të drejtat lidhur me angazhimin për punë janë të rregulluara me Rregulloren e rendit shtëpiak.

Personat e paraburgosur mund të angazhohen për punë me kërkesë të vet, me pëlqim të gjykatësit për investigim ose të kryetarit të Këshillit Gjyqësor dhe pëlqimin e personit i cili udhëheq me burgun.

### ✓ ***Arsimimi***

Në burg mund të kryeni kursin e shkrimleximit, mund të kryeni shkollën fillore, mund të fitoni arsimin profesional, ndërsa mund të Ju mundësohet që të jepni provimet edhe jashtë hapësirës së Entit, në pajtim me Ligjin për



Kryerjen e Sanksioneve Penale dhe Rregulloren mbi rendin shtëpiak për kryerjen e ndëshkimeve me burg.

✓ ***Biblioteka***

Në Ent ekziston biblioteka, në të cilën mund të huazoni ligje, rregullore, libra të ndryshëm dhe libra shkollorë, raporte për respektimin e të drejtave të burgosurve, etj. Kërkoni nga zyrtari/ja e sigurimit ose trajtimit të Ju mundësojë listën e librave dhe botimeve që janë në dispozicion në bibliotekë.

# Akomodimi i grupeve të veçanta të burgosurve dhe të burgosurave dhe trajtimi i tyre

## ✓ *Personat me invaliditet*

Personat me invaliditet duhet të jenë të akomoduar në hapësirat e përshtatura për nevojat e tyre, gjegjësisht gjendjen e tyre shëndetësore. Kjo posaçërisht ka të bëjë me personat të cilët lëvizin me vështirësi dhe personat të cilët për lëvizje përdorin karrocën, si dhe personat e verbër dhe personat me shikim të dëmtuar.

Personat me invaliditete të cilët kanë vështirësi të bëjnë diçka do të duhej t'i drejtohen personelit të entit, i cili është i obliguar t'u ndihmojë.

Personat me invaliditet mund të gjejnë më shumë informata mbi jetën në burg dhe për atë se si mund të fitojnë ndihmë në Ent në Manualin e posaçëm me informata për të burgosurit me invaliditet.

### ✓ **Personat e mitur**

Personat e dënuar të moshës së mitur akomodohen në repartin e veçantë për të miturit.

Të miturit/at ndëshkimi me burg e ekzekutojnë në kushte të cilat dallojnë nga ato të cilat vlejné për personat e dënuar, të cilët janë në moshë të rritur.

Kushtet në të cilat të miturit e kryejné ndëshkimin me burg janë të përcaktuara me Rregulloren e rendit shtëpiak.

### ✓ **Gratë (Femrat)**

Gratë ndëshkimet me burg i kryejné në repartin e posaçëm të Entit (Repartin e Grave).

Në kuadër të Repartit të Grave, grave sh-tatzëna dhe nënave me fëmijë u mundësohet qendrimi në hapësirat e veçanta që i plotësojnë kushtet për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve.

Një fëmijë që është lindur nga një grua e dënuar gjatë kryerjes së ndëshkimit, mund të qëndrojë në këto hapësira deri sa të arrijë moshën njëvjeçare.

Gratë e dënuara mund të marrin pjesë në aktivitetet e punës, sportive, kulturo-artistike dhe aktivitetet e lira së bashku me meshkujt e dënuar, me lejen e shefit të Konviktit për Ndëshkim dhe Përmirësim, dhe nën kontrollin dhe mbikqyrjen e realizuesit të trajtimit dhe oficerëve të Sektorit të sigurimit.

## Masat e veçanta

### ✓ *Izolimi*

Ndaj personit të dënuar i cili e pengon me këmbëngulje zhvillimin e punës dhe jetës në organizatë dhe ndaj të cilit ndëshkimet e tjera disiplinore të rregullta kanë qenë të pasuksesshme dhe kështu paraqet një rrezik për personat e tjerë të dënuar dhe për sigurinë, drejtori i Entit mund të caktojë izolimin gjatë orëve të lira, që mund të zgjasë prej 1 muaj deri në 1 vit.

Vendimi me të cilin përcaktohet izolimi duhet të jetë në formë të shkruar, duhet të arsy-

tohet dhe t'i parashtrohet personit me të cilin ka të bëjë, me udhëzimin për mjetin juridik.

Kundër vendimit me të cilin është përcaktuar izolimi mund të parashtrohet ankesa. Personat të cilëve u është përcaktuar izolimi duhet të jenë të izoluar nga personat e tjerë të dënuar dhe duhet të nxirren në shëtitje në kohëzgjatjen pre një orë në ditë.

Personit të cilit i është përcaktuar masa e izolimit ka të drejtë për vizita dhe biseda telefonike.

Izolimi ndërpritet menjëherë me pushimin e arsyeve për shkak të të cilave është përcaktuar. Drejtoria e Entit është e obliguar që për një periudhë të caktuar të rishqyrtojë se a ekzistojnë edhe më tutje arsyet për izolim.

Izolimi ndërpritet kur me dokumentacion mjekësor përcaktohet se gjendja trupore dhe shpirtërore e personit të dënuar nuk lejon izolimin e mëtejshëm.

### ✓ **Transferimi**

Personi i dënura mund të transferohet nga

njëra njësi organizative në tjetrën kur kjo është e nevojshme për shkak të zbatimit të trajtimit të përcaktuar, për arsye shëndetësore, për arsye të sigurisë dhe mbajtjes së rendit dhe disiplinës.

Vendimin për transferim e merr drejtori i Entit dhe ky duhet të përmbajë mësimin lidhur me ilaçin juridik. Kundër këtij vendim mund të ankoheni.

## Procedura disiplinore

### ✓ *Procedura disiplinore kundër personit të dënuar*

Për shkeljen e rregullave të shtëpisë, gje-gjesisht shkeljeve disiplinore, mund të ndëshkoheni në mënyrë disiplinore.

Shkeljet e disiplinës janë të përcaktuara me Rregulloren e rendit shtëpiak.

Personit të dënuar mund t'i shqiptohen sanksionet disiplinore të mëposhtme:

- Qortimi;

- Ndalimi i pranimit të dërgesave deri në tre muaj;

- Nisja në dhomë njëshe (të izolimit) deri në 30 ditë pas kryerjes së detyrimeve të punës dhe

- Nisja në izolim deri në 30 ditë.

Sanksionet disiplinore përcaktohen në procesin disiplinor.

Procedura disiplinore fillon me parashtrimin e padisë disiplinore dhe me thirrjen e personit të dënuar në të ashtuquajturin „raport“ tek shefi i burgut.

Në procedurën disiplinore, personi kundër të cilit udhëhiqet procesi duhet të ftohet në seancën e dëgjimit, gjegjësisht, duhet të njohet me akuzat nga paraqitja disiplinore para se të japin deklaratën mbi përgjegjësinë e vet.

Nëse procesi udhëhiqet për shkak të shkeljes për të cilën mund të shqiptohet masa për dërgim në izolim personi i dënuar mundet që, me shpenzime të veta, të angazhojë avokatin e zgjedhur nga ana e tij në afatin kohor prej 24 orësh nga parashtrimi i padisë disiplinore.

Nëse personi i dënuar nuk e siguron avokatin nga radhët e avoketërve, mund të kërkojë që në procedurën disiplinore ta përfaqësojë personi zyrtar nga një organizatë e autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike.

Vendimi për shqiptimin e ndëshkimit disiplinor duhet të jetë me shkrim dhe i arsyetuar dhe duhet t'i parashtrohet personit të cilit i shqiptohet.

Ankesa ndaj vendimit për shqiptimin e ndëshkimit disiplinor mund t'i parashtrohet drejtorit të Entit. Ankesa parashtrohet në afatin kohor prej tri ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

Nëse personi i dënuar, pas vendimit të drejtorit të Entit, nuk është i kënaqur, mund të parashtojë ankesën pranë Gjyqit Administrativ të Malit të Zi.

### ✓ ***Procedura disiplinore në paraburgim***

Për shkeljet disiplinore të personave të paraburgosur, personi i cili udhëheq Entin ose personi të cilin ai e autorizon mund të shqiptojë ndëshkimin disiplinor të kufizimit të vizitës ose dërgimit në dhomë njëshe (izolim) deri në 15 ditë.



Shkeljet disiplinore janë të përcaktuara me Rregulloren për mënyrën më të detajuar të ekzekutimit të paraburgimit.

Kundër vendimit për ndëshkim ankesa mund t'i parashtrohet gjykatësit për investigim në afatin kohor prej 24 orëve.

### ✓ **Dërgimi në birucë**

Ndëshkimi disiplinor i dërgimit në birucë përbëhet nga qëndrimi i pandërprerë i personit të dënuar në hapësirë të caktuar, krahas shëtitjes ditore në hapësirë të hapur në kohëzgjatje prej më së paku një orë.

Gjatë kohës së ekzekutimit të ndëshkimit disiplinor personin e dënuar e vizitojnë, më së paku një herë në ditë, edukatori dhe mjeku.

Ndëshkimi disiplinor në birucë nuk mund të ekzekutohet në qoftë se me këtë rrezikohet shëndeti i personit të dënuar.

Ekzekutimi i ndëshkimit disiplinor me dërgim në birucë do të ndërpritet në qoftë se do të konstatohet se është arritur qëllimi i ndëshkimit disiplinor, ose për shkak të sëmundjes së personit të dënuar.

Personit i cili qëndron në birucë nuk guxohet t'i ndërpritet ose kufizohet e drejta e pranimi të vizitave.

Gjatë kohë së qëndrimit në birucë keni të drejtë të lexoni libra dhe materiale të tjera.

## Mbrojtja e të drejtave

### ✓ *Ankesa në kuadër të Entit*

Në qoftë se mendoni se Jua kanë shkelur të drejtën lidhur me kryerjen e ndëshkimit, ose për shkak të padrejtësive të tjera, të cilat Ju janë bërë, keni të drejtë të parashtroni ankesë te drejtori i Entit.

Ankesa duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përmbajë përshkrimin e fakteve dhe veprimeve, për shkak të të cilave mendoni se Ju janë shkelur të drejtat Tuaja ose ndaj Jush nuk është vepruar në mënyrë të drejtë.

Ankesën e futni në kutinë e shkresave, e cila në veçanti dedikohet për këto qëllime, e cila ndodhet në korridorin e burgut, ose mund t'ia

dorëzoni edhe zyrtarit të autorizuar për sigurim ose trajtim ose punë.

Nëse personi i cili dëshiron të parashtrojë ankesën është analfabet, zyrtari i autorizuar i Sektorit për trajtimin e personave të dënuar të Entit ndihmon ankesën ose ankesën e merr në bazë të procesverbalit.

Për të sqaruar më mirë se për çka ankohet konkretisht, ose që ankesa të zgjidhet drejtëpërdrejtë, personi i dënuar mund të kërkojë që të nxirret në raportin për ankesa.

Personi i dënuar është i obliguar që gjatë kohës së raportit të prezantohet, të paraqesë dhe arsyetojë ankesën e vet.

Pasi ta ketë dëgjuar, shefi i njësisë organizative menjëherë, nëse është e mundur, do të kumtojë vendimin e vetë lidhur me ankesën, ose vendimin do ta marrë në afatin kohor prej 48 orëve, për çka menjëherë njoftohet personi i dënuar.

### ✓ **Ankesa e Ministrisë së Drejtësisë**

Ministria e Drejtësisë kryen kontrollin e ligjshmërisë së ndëshkimeve të ekzekutuara.

Në qoftë se jeni person i dënuar, anksën lidhur me shkeljen e të drejtës deri tek e cila ka ardhur në Ent dhe për të cilën përgjegjës e konsideroni Entin, mund t'ia parashtroni zyrtarit gjegjës për pranimin e ankesave në Drejtorinë për Kryerjen e Sansksioneve Penale të Ministrisë së Drejtësisë.

✓ **Ankesa kryetarit të gjykatës ose gjyqtarit i cili mbikqyrë kryerjen e paraburgimit**

Kryetari i Gjykatës përkatëse ose gjykatësi të cilin e sakton ai është i obliguar që ta mbikqyrë kryerjen e paraburgimit. Nëse jeni person në paraburgim, atij mund t'ia parashtroni ankesën për shkak të shkeljes së të drejtës që ka ndodhur në paraburgim.

Mbrojtja në procedurën të cilin e udhëheq Mbrojtësi/ja e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut i/e Malit të Zi.

Të burgosurit ankesën mund t'ia parashtrajnë Mbrojtësit/es së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në kutinë për shkresa, e cila ndodhet në korridorin e burgut. Çelësin e kësaj kutie e ka vetëm Mbrojtësi/ja, gjegjësisht zyrtari/ja i/e tij i/e autorizuar.

Ankesa duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përmbajë emrin e organit me punën e të cilit ka të bëjë, përshkrimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe provat të cilat e mbështesin ankesën, të dhënat mbi atë se cilat mjete juridike/ligjore janë përdorur, emrin personal dhe adresën e parashtruesit/parashtrueses së ankesës dhe të dhënë se a është parashtruesi/parashtruesja dakord që emri i tij/saj të zbulohet gjatë procedurës.

Ankesa duhet të parashtrohet në afatin kohor prej gjashtë muaj nga dita kur i burgosuri ka kuptuar shkeljen e të drejtave të njeriut, ndërsa më së largu një vit nga kryerja e shkeljes.

Procedura të cilën e udhëheq Mbrojtësi/ja e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut është përcaktuar në mënyrë të detajuar me Ligjin për Mbrojtësin/en e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi.

### ✓ **Mbrojtja gjyqësore**

Nëse mendoni se ndaj Jush ose ndaj një të burgosuri ose të burgosure është kryer shkelja e

të drejtave e cila paraqet vepër penale, mund të parashtroni aktpadinë penale pranë prokurorit shtetëror, përmes drejtorisë së EESP-së, gjegjësisht zyrtarit të sigurimit dhe zyrtarit kompetent për trajtim.

Aktpadia penale mund të parashtrohet edhe me ndërmjetësimin e personit tjetër. Për shembull, lidhur me veprën penale mund të informoni, gjatë vizitës, të afërmit ose avokatin tuaj, ndërsa ata mund të njoftojnë prokurorinë.

Në paraqitjen penale duhet të deklaroni të gjitha faktet dhe provat

Aktpadia penale mund t'i parashrohet edhe gjykatës, ose policisë, ose Mbrojtësit/ es e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, të cilët pastaj janë të obliguar që t'ia tranferojnë prokurorisë gjegjëse.





AKCIJA ZA  
LJUDSKA  
PRAVA



Centar za građansko obrazovanje



**SIGURNA ŽENSKA KUĆA**



**EKVISTA**  
Centar za antidiskriminaciju

